

Data 28.06.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal Elbasan”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) 15894220-9.

VLERA E FONDIT LIMIT: 155,897,854.28 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër pikë njëzet e tetë) lekë pa TVSH ose 1,554,160.64 (një milion e pesëqind e pesëdhjetë e katërmijë e njëqind e gjashtëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e katër) Euro pa TVSH.

(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (100.31), datë 28.06.2024, ora: 13:02).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”. Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik (Në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 ”Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr.538, datë 26.05.2009 ”Për licencat që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) apo disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore.

Në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licencuar, sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nën ligjore.

Licenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter më sipër është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate.

2.1.2 Operatorët ekonomikë, duhet të posedojnë të paktën 1 (një) stabiliment të licensuar për prodhimin e ushqimit. Ky stabiliment duhet të jetë brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër. Objekti mund të jetë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratë qiraje ose përdorimi, ku të identifikohet dhe vendndodhja brenda bashkisë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e një stabilimenti të licensuar, është vendosur bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

Kërkohet që stabilimenti të ndodhet brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër, pasi ushqimi do të përgatitet në atë ambient dhe më pas do të transportohet në qendrat ku ndodhen pacientët dhe stafi mjekësor. Duke qenë se ushqimi duhet të jetë i gatuar rishtaz, vendodhja e stabilimentit brenda territorit të bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër, siguron gatimin dhe shpërndarjen e gatimit, në kohë, brenda standarteve dhe kërkesave të cilësisë të kërkuara.

2.1.3 Operatorët ekonomikë, duhet të paraqesin një deklaratë se stabilimenti plotëson kushtet higjieno-sanitare dhe tekniko-teknologjike për veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes me shumicë të ushqimeve për njerëz.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që

prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, dhe në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, me qëllim që AK të krijojë siguri se ofertuesi gjatë ushtrimit të veprimtarinë e tij plotëson kushtet higjieno sanitare dhe tekniko-teknologjike, të lidhura me objektin e prokurimit.

2.1.4 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe bazuar në objektin e prokurimit, në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, me qëllim që AK të krijojë siguri se ofertuesi gjatë ushtrimit të veprimtarinë e tij plotëson kushtet ligjore, të lidhura me objektin e prokurimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomik-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022, 2023), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) **për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.**
- b) **për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

SH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore.

Duke qenë se ky standart specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të sigurisë ushqimore për të mundësuar një operator, që është i përfshirë drejtpërdrejtë ose tërthorazi në zinxhirin ushqimor: të planifikojë, zbatojë, operojë, mirëmbajë dhe përditësojë një sistem që ofron produkte dhe shërbime që janë të sigurta, në përputhje me përdorimin e tyre të synuar, për të demonstruar pajtueshmërinë me kërkesat e aplikueshme statutores dhe rregullatore të sigurisë ushqimore, të vlerësojë dhe vlerësojë kërkesat e klientëve për sigurinë ushqimore të miratuara reciprokisht dhe të demonstrojë konformitetin me to, të komunikojë në mënyrë efektive çështjet e sigurisë ushqimore palëve të interesuara brenda zinxhirit ushqimor; etj.;

Si dhe duke vlerësuar që të gjitha kërkesat e këtij dokumenti janë të përgjithshme dhe synohen të zbatohen për të gjitha organizatat që janë të përfshira drejtpërdrejt ose tërthorazi, në zinxhirin ushqimor, pavarësisht nga madhësia dhe kompleksiteti;

Kërkesa e mësipërme lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri që shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit do të kryhet konform standarteve të kërkuara.

2.3.3 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të kenë jo më pak se 14 (katërmëdhjetë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1.	Drejtues teknik Mercollog/Kimist	1 (një)
2.	Kuzhinier	2 (dy)
3.	Ndihmës Kuzhinier	4 (katër)
4.	Punonjës shpërndarës ushqimesh në ambjentet e AK	6 (gjashtë)
5.	Shofer	1 (një)
	Total	14 (katërmëdhjetë)

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

a) Për drejtuesin teknik/(Mercollog/Kimist):

- Diplomë me profesion Mercollog/Kimist,
- Kontratë pune (e vlefshme), si drejtues teknik;
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspëriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 (dy) vite.

b) Për Kuzhinierin:

- Diplomë ose certifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional,
- Kontratë pune si kuzhinier, (e vlefshme)

- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 (dy) vite.

c) Për ndihmës kuzhinierin:

- Kontratë pune si ndihmës kuzhinier, (e vlefshme)
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 1 (një) vit.

d) Për punonjësit për shpërndarje ushqimi, të paraqitet:

- Kontratë pune si shpërndarës ushqimi, (e vlefshme)

dh) Për punonjësit Shofer, të paraqitet:

- Kontratë pune si shofer, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi, për mjetin e kërkuar, në përputhje me Legjislacionin në fuqi

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK. Në këto dokumenta specifikohet se duhet të sigurohet ushqimi i freskët, i shëndetshëm, i kontrolluar dhe sipas dietave të përcaktuara nga MSH. Ushqimet, do të përpunohen, gatuhet, transportohet dhe shpërndahet ushqimi tek pacientet tre herë në ditë, për tre vakte. Operatorët ekonomik, me anë të stafit të kërkuar, do të kryejnë në mënyrë shteruese shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit. Shërbimi do të garantohet për 24 njëzet e katër orë.

Referuar sa më sipër, operatori ekonomik duhet të disponojë një person përgjegjës (drejtues teknik) mercollog/kimist, i cili ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit të prokurimit, në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara. Duke qenë se ndër proceset e objektit të prokurimit, përfshihet gatimi, kuzhinieri dhe ndihmës kuzhinieri janë të lidhur ngushtë me zbatimin e këtij procesi dhe përgatitjes së menuve të përcaktuara në DST. Punonjësit për shpërndarje ushqimi dhe shoferi, lidhen ngushtë me procesin e shpërndarjes së ushqimit, duke siguruar ekzekutimin e këtij procesi në kohë dhe brenda orareve të caktuara në DST.

Vitet e eksperiencës për drejtuesin teknik, kuzhinierin dhe ndihmës kuzhinierin janë vendosur duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e shërbimit, objekt prokurimi, kryerjen e tij në përputhje me oraret e vendosura nga AK.

Duke vlerësuar që ushqimi duhet të ofrohet deri tek pacienti në SRE, duhet të përmbajë vlerat kalorike aq sa mjeku kurues e përcakton në terapinë e tij ditore sikundër vepron dhe me medikamentet, vitet e eksperiencës për secilin janë minimale dhe sigurojnë AK që këta punonjës që do të angazhohen për këtë procedurë prokurimi kanë eksperiencën e duhur për të përgatitur dietat përkatëse, sipas përshkrimit të tyre.

Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës në të cilat duhe të përmbushë ky shërbim.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.4 Operatët ekonomikë duhet të deklarojnë se punonjësit e deklaruar për këtë procedurë prokurimi nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

Argumentimi:

Në zbatim të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si dhe duke vlerësuar ndjeshmërinë e shërbimeve, objekt prokurimi, ku kërkohet një shërbim i përditshëm dhe me kohëzgjatje 24 h ndaj pacientëve në spital, punonjësit e kërkuar kërkohet të jenë të punësuar me kohë të plotë në këtë marrëveshje kuadër, duke garantuar kështu ekzekutimin e kontratës/kontratave që do të nënshkruhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, në kohë dhe cilësi.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqiten dokumentacioni e plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjeti frigoriferik për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e mjetit frigoriferik është në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, dhe shërben për të transportuar ushqimin, duke siguruar shpërndarjen e ushqimit me cilësinë e kërkuar, në tre vaktet e përcaktuara.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës të deklarojnë se mundësojnë transportimin e ushqimit me mjetet e veta, deri në ambientet e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si dhe duke iu referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi disponon mjetet e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pjesë përbërëse e së cilit është edhe shpërndarja e ushqimit.

2.3.7 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë se ushqimi do të etiketohet dhe do të identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër, për të siguruar gjurmueshmërinë e tij sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si dhe VKM-së Nr.760 datë 16.09.2015 “Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshët përgjatë ushqimit ushqimor”, O.E. duhet që në çdo kohë të shoqërojë ushqimin e gatuar me dokumentacionin përkatës deri në konsumimin e plotë të tij dhe të garantojë sigurinë e produktit nëpërmjet gjurmueshmërisë së tij.

2.3.8 Operatorë ekonomikë duhet të deklarojnë disponimin ose mundësinë e disponimit të materialeve dhe mjeteve profesionale të domosdoshme/inventari i imët.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si dhe duke iu referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi disponon mjetet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës/ava që do të nënshkruhen në zbatim të marrëveshjes kuadër.

2.3.9 Operatorë ekonomikë duhet të deklarojnë se produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve janë në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi, konform manualit të vetekontrollit HACCP.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, si dhe duke iu referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës, me qëllim që AK të krijojë siguri që ofertuesi do të përgatisë ushqimet konform standarteve të kërkuara dhe manualit HACCP.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentat e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentat e kërkuar sipas legjislacionit të fushës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Spitali Rajonal Elbasan”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT